



Enti Rregullator i Energjisë për Shqipërinë (ERE) dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vienë (ECS), shkëmbyen mendime mbi zhvillimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

20.04.2023

Më 19 prill 2023, përfaqësues të ERE vizituan ambientet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Vienë, për një takim dy palësh. Të dy institucionet kanë një histori të gjatë të bashkëpunimit të suksesshëm në reformat e tregut të energjisë në Shqipëri. Delegacioni Shqipëtar drejtohej nga Kryetari i ERE-s z. Petrit Ahmeti.

Takimi u fokusua në zhvillimet e mëtejshme të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri, pas nisjes së tregut të energjisë së ditës në avancë më 11 prill të këtij viti, të operuar nga Bursa Shqipëtare e Energjisë - ALPEX sh.a.. Këto zhvillime përfshijnë, ndër të tjera, transpozimin dhe zbatimin e paketës së integritetit të tregut të energjisë elektrike, të miratuar nga Këshilli i Ministrave të Komunitetit të Energjisë në dhjetor 2022, përcaktimin e Operatorit të Nominuar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), projektet e bashkimit të tregjeve, duke përfshirë hapat dhe sfidat e ardhshme për t'iu bashkuar tregut të përbashkët të BE-së dhe roli monitorues i ERE-s në këtë proces.

Në fjalën e tij Kryetari i ERE-s z. Ahmeti theksoi angazhimin dhe vendosmerinë e institucionit për përballimin e sfidave që dalin përpara si rezultat i zhvillimeve në sektor, të cilat lidhen me operimin e tregut të ditës në avancë, bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike me Kosovën dhe me rajonin e më gjërë, bashkërendimin me palët e interesuara për ndryshimet ligjore dhe rregullatore për adaptimin e paketës së elektricitetit si dhe akteve rregullatore që lidhen me ligjin e ri të burimeve të rinovueshme. Z. Ahmeti shprehu ndër të tjera kënaqësinë për bashkëpunimin frytdhënës midis të dy institucioneve si dhe besimin se ky bashkëpunim do të zhvillohet më tej dhe në të ardhmen.

Zëvendës drejtori i Sekretariatit, z. Dirk Buschle, ndër të tjera u shpreh se: “Shqipëria ka marrë sërish një rol drejtues në zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në rajon kohët e fundit. Sfidat tani do të jetë sigurimi që ALPEX sh.a. të bëhet një treg likuid, i përdorur nga operatorët publik dhe privat. Roli i ERE-s në këtë prizëm si dhe në integrimin e Shqipërisë në tregjet evropiane të energjisë ka qënë dhe do të jetë vendimtar. Duke marrë përsipër përgjegjësinë për lëshimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme sipas sistemit rajonal, të krijuar nga Sekretariati, ERE do të sigurohet gjithashtu, që begatia që Shqipëria ka me energjinë e gjelbër, të marrë vlerën e duhur, për hir të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane.”